*Specialist në Sektorin e Trajnimeve për Gjeoinformacionin,, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor""", të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor", Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Trajnimeve për Gjeoinformacionin,, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Kryerjen e organizimit, planifikimit dhe drejtimin e programeve të trajnimit për grupet e synuara;
2. Ndjekjen e zhvillimit të trajnimeve dhe monitoron realizimin e tyre nëpërmjet ndjekjes me rigorozitet të programit dhe kryen raportimet tek Përgjegjësi i Sektorit të Trajnimeve;
3. Bashkëpunimin me ekipin e trajnerëve për t'u siguruar për bazën e duhur materiale gjatë trajnimit;
4. Bashkëpunimin me strukturat e ASIG duke mbështetur dhe kontribuar në procesin e hartimit të kurrikulave të programeve të trajnimit që do të ofrohen.
5. Hartimin dhe rishikimin e kontratave, marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe/ose çdo angazhim tjetër me shkrim të ASIG me palët e treta në funksion të organizimit të trajnimeve për fushën e gjeoinformacionit.
6. Raportimin tek Përgjegjësi i Sektorit të Trajnimeve për performancën e realizimit të trajnimeve, duke përfshirë dhe vlerësimet e pjesëmarrësve për programin e ndjekur;
7. Përgjigjen për kontrollin e çdo punimi në mënyrë që produkti të jetë në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe t'i shërbejë realizimit të objektivave institucionale;
8. Përgjigjet për referimin tek eprorët të çdo problematike të identifikuar gjatë procesit të kryerjes së punës dhe bën rekomandimet përkatëse tek Përgjegjësi i Sektorit të Trajnimeve apo Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve;
9. Koordinimin në mënyrë sistematike detyrat midis ekipit të trajnerëve dhe kërkesave të institucioneve përfituese, duke garantuar realizimin në kohë dhe me cilësi të programeve të trajnimit;

10. Menaxhimin e bazës së të dhënave dhe çdo informacion tjetër të krijuar apo marrë në dorëzim, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi;
11. Përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit të Trajnimeve dhe Drejtorin e Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë procesit të punës;
12. Përgatitjen sipas udhëzimeve të eprorit direkt dokumenta teknike (për fushën që mbulon) në bazë të detyrave që kryen sektori apo drejtoria ku punon;
13. Përfaqësimin e institucionit në raste të veçanta, me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve e miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.

## KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit "Master Shkencor ose profesional" në Shkenca Juridike/ Administrim Publik;
2. Të ketë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse;
3. Të ketë njohuri të fushës, të teknikës së hartimit të akteve dhe dokumenteve institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, aftësi për të vlerësuar opsione zgjidhjesh dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;
4. Të ketë njohuri të fushës së marrëdhënieve dhe komunikimit, aftësi për të evidentuar arritjet dhe objektivat institucionale;
5. Të zotërojë aftësi shuma të mira komunikimi dhe raportimi dhe aftësi për të punuar në grup;
6. Të njohë mirë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe kuadrin ligjor të autoriteteve përgjegjëse, sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, për këtë informacion si dhe legjislacionin e BE që lidhen me gjeoinformacionin (Direktiva INSPIRE);
7. Të ketë eksperiencë ne organizimin e trajnimeve, seminareve/workshops në sektorin që mbulon ASIG;
8. Të njohë shumë mirë gjuhën angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

## PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË ( IV-1 )

## PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 28.01.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e–mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV

10. Menaxhimin e bazës së të dhënave dhe çdo informacion tjetër të krijuar apo marrë në dorëzim, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi;
11. Përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit të Trajnimeve dhe Drejtorin e Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë procesit të punës;
12. Përgatitjen sipas udhëzimeve të eprorit direkt dokumenta teknike (për fushën që mbulon) në bazë të detyrave që kryen sektori apo drejtoria ku punon;
13. Përfaqësimin e institucionit në raste të veçanta, me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve e miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.

## KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të ketë mbaruar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit "Master Shkencor ose profesional" në Shkenca Juridike, Menaxhim, apo të ngjashme;
2. Të ketë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse;
3. Të ketë njohuri të fushës, të teknikës së hartimit të akteve dhe dokumenteve institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, aftësi për të vlerësuar opsione zgjidhjesh dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;
4. Të ketë njohuri të fushës së marrëdhënieve dhe komunikimit, aftësi për të evidentuar arritjet dhe objektivat institucionale;
5. Të zotërojë aftësi shuma të mira komunikimi dhe raportimi dhe aftësi për të punuar në grup;
6. Të njohë mirë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe kuadrin ligjor të autoriteteve përgjegjëse, sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, për këtë informacion si dhe legjislacionin e BE që lidhen me gjeoinformacionin (Direktiva INSPIRE);
7. Të ketë eksperiencë ne organizimin e trajnimeve, seminareve/workshops në sektorin që mbulon ASIG;
8. Të njohë shumë mirë gjuhën angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

## PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË ( IV-1 )

## PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 28.01.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e–mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV

- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.